

Guri 7 – Samsoni, Perëndia është forca jonë

Objektivat:

- Nxënësit të mësojnë historinë e Samsonit dhe të kuptojnë se forca e Samsonit vinte nga prania e Perëndisë në jetën e tij.
- Nxënësit të kuptojnë se forca jonë është përmes jetës me Krishtin.
- Nxënësit të nxiten të lexojnë gjatë javës nga Bibla “Fëmijët Lexojnë Shkrimin e Shenjtë” nga fq 105-112 si dhe të inkurajohen ti luten Krishtit që t’i ndihmojë ata në çdo gjë që bëjnë.

Vargu përmendësh: Mund të bëj gjithçka përmes Krishtit që më forcon (Filipianët 4:13).

Materialet:

Vidio e dulbuar në shqip. <http://www.youtube.com/watch?v=dnNjMsqSyEo>

Nga një tollumbac për çdo fëmijë në dy grupet e mëdha, fleta e punës për aktivitetin në grup të vogël me deshifrimin e shprehjes.

Në grup të madh: Mirdita. Shpresoj që të keni kaluar mirë gjatë javës. Ne ju kishim nxitur të lexonit disa pjesë nga Bibla gjatë javës. Kush prej jush do të më tregojë njëerën prej historive që ju keni lexuar (Gjarpri që shëron, Vdekja e Moisiut, Jisui i Naviut udhëheq popullin ose i njohur ndryshe si Jozueu, Shembja e mureve të Jerikosë, Toka e Premtuar). Dikush tjetër të më tregojë një tjetër? Derisa disa prej tyre janë thënë.

Pastaj vazhdo: Deri tani kemi parë se si Perëndia ka punuar për të shpëtuar popullin e Izraelit. Ai i nxori ata prej Egjiptit dhe i solli në Tokën e Premtuar. Izraelitët ranë sërish në mëkat dhe Perëndia përsëri vepron për t’i shpëtuar duke dërguar gjyqtarët. Kjo periudhë në historinë e Izraelit është njohur si periudha e gjyqtarëve. Sot ne do të shohim në mënyrë të veçantë historinë e Samsonit.

Ndjekim filmin vizatimor. <http://www.youtube.com/watch?v=dnNjMsqSyEo>

Pas filmit do të mësojmë **këngën:**

Mund të bëj gjithçka

Mund të bëj gjithçka (3x)

përmes Krishtit që m’forcon (Filipianët 4:13)(2x)

Do të jem i sjellshëm
Se Krishti më jep forcë
Do them të vërtetën
Se Krishti më jep forcë
Do të jem i dashur
Se Krishti më jep forcë
Do të kem gëzim
Se Krishti më jep forcë

Mund të bëj gjithçka (3x)
përmes Krishtit që m'forcon (Filipianët 4:13)

Do të kem durim
Se Krishti më jep forcë
Do të jem besnik
Se Krishti më jep forcë
Do të jem i ëmbël
Se Krishti më jep forcë
Do të përkujdesem
Se Krishti më jep forcë

Mund të bëj gjithçka (3x)
përmes Krishtit që m'forcon (Filipianët 4:13)

Pastaj **vargu përmendësh** i cili do të jetë Filipianët 4:13.

Në grup të vogël:

Kur fëmijët të vijnë në grup të vogël jepini nga një tollumbac të fryrë për ta çarë. Pyetini ata se çfarë u nevojitje që të çanim tollumbacin? (Forcë) Ashtu si edhe Samsoni ne duhet të ishim të fortë që të çanim tollumbacen.

Çfarë ju bëri përshtypje nga historia e Samsonit dhe pse? (Prit nëse ndonjë nga fëmijët do të përmendi faktin që Samsoni ishte i fortë për sa kohë Perëndia ishte me të, por kur Perëndia u largua prej tij për shkak të mos mbajtjes së premtimit nga Samsoni, ai nuk ishte më i fortë. Nëse asnjëri prej fëmijëve nuk e thotë këtë ti si mësues thuaje si gjënë që të bëri ty përshtypje.)

Ashtu si Samsoni i cili kur ishte me Perëndinë ishte i fortë edhe ne si Qytetar të Mbretërisë së Perëndisë jemi të fortë kur Krishti banon brenda nesh, kur ne jetojmë një jetë sipas vullnetit të Perëndisë. Ndahuni në grupe me nga 4 persona dhe listoni disa prej gjërave që tregojnë se ne jetojmë një jetë sipas dëshirës së Perëndisë. Për t'ju ndihmuar thoni fëmijëve, kujtoni fjalët e këngës që sapo mësuam. (Kur jetojmë me Krishtin ne duam me dashuri pa kushte ashtu si Ai na deshi ne, kur tregojmë të vërtetën, kur jetojmë një jetë të mbushur me gëzimin e Zotit, kur sillemi mirë, kur tregohemi të duruar, kur kujdesemi për të tjerët për shokët në shkollë që nuk i afron askush apo për një të moshuar, apo për dikë të sëmurë, apo kur ndihmojmë prindërit, etj., kur jemi besnik ndaj Zotit dhe fjalëve të Tij duke bërë ato që ai na mëson.) Një përfaqësues nga grupi të tregojë disa nga gjërat që ju si grup keni shkruar në listën tuaj.

Gjatë javës që po vjen do t'ju lutesha të lexonit nga Bibla *Fëmijët lexojnë Shkrimin e Shenjtë* fq. 105-112 për të mësuar më shumë rreth gjyqtarëve dhe si Perëndia i përdori ata. Gjithashtu në lutjen tuaj këtë javë kërkojini Zotit t'ju japi forcë për të bërë gjithçka që është e dobishme dhe e mirë për ju. Lutjuni Zotit të jetë me ju në çdo moment kur jeni në shkollë, para një provimi, në shtëpi apo duke luajtur.

